

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Isa Kelmendi, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses S. Xh.,nga ..., kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a. në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Hajredin Islami, për shkak të kompensimit të diferencës së pagës, duke vendosur sipas revizionit të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.266/2018 datë 30.5.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 23.10.2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.266/2018 datë 30.5.2018

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.266/2018 datë 30.5.2018 është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.312/17 datë 16/10.2017, në pjesën me të cilën është obliguar e paditura që paditëse t'ia paguaj në emër të ndryshimit të pagës në mes të gradës 14 dhe 13 duke filluar nga data 01.2.2012 e deri m[ë datën 02.4.2013, shumën neto prej 3.088.00 € ,me kamatë në lartësi prej 468.29 €, duke filluar nga data 01.02.2012,e diferencën e kontributit pensional në fondin e trustit pensional në shumën prej 181.00 €,tatimin në paga në shumën prej 343.00 €, e që bruto në shumën prej 3,612.00 € e deri në pagesën e plotë , si dhe shpenzimet procedurale në shumën prej 180.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi nën kërcënim përmbartimit me dhunë .

Në pjesën me të cilën që ka të bëjë anulimin e aktvendimeve të paditurës Nr..., të datës ....., me të cilën paditësit kanë zvogëluar gradën prej 14-ve në 13, në këtë pjesë është anuluar aktgjykimi gjykatës së shkallës së parë për shkak se në këtë pjesë çështja është gjykuar .Në pjesën refuzuese aktgjykimi i shkallës ë parë mbetet e pashqyrtuar

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë, në afat ligjor revizion ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e të dy gjykatave të ndryshohen dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit apo të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi në bazë të kontratës së punës, ka themeluar marrëdhënie pune te e paditura në detyrat e punës Menaxhere financiare në njësinë Vala ,në Prishtinë. Në nenin 5 të kësaj kontrate parashihet që paditësit për punën e kryer t'i kompensohet me pagë të përcaktuar me gradën e 14 të. Kryeshefi i PTK, duke u bazuar në vendimeve të Bordit të Drejtorëve të paditurës Nr....., të datës ..., paditëses i është zvogëluar grada prej 14 në gradën 13, dhe atë sipas rekomandimit të aksionarit të paditurës Qeverisë së Republikës së Kosovës për reduktimin e s shpenzimeve në PTK. Kundër aktvendimit të sipërcituar, paditësi ka ushtruar ankesë mirëpo përgjigje nuk ka marrë.

Gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se sipas nenit 5 të kontratës së punës lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës është caktuar paga bazë për punën e kryer në lartësi të gradës 9-të dhe se nga pala kontraktuese duhet të respektohen dispozitat e kontratës. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë kushtet e kontratës së lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës ,duke përfshirë edhe lartësinë pagës , përkatësisht të gradës sipas të cilës do të paguhet paga e paditësit janë në harmoni me neni 55.1 të Ligjit të punës .Se e paditura është obliguar të respektoj dispozita e kontratës dhe se nuk mund të ndryshohen kushtet e kontratës me vullnet njëanshëm por me vullnetin e shprehur të dy palëve kontraktuese.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë .

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike drejt ka zbatuar dispozitat e Ligjit të procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka pranuar si të pabazuar padinë e paditësit. Kjo Gjykatë, vlerëson si të drejtë dhe ligjshëm qëndrimin juridik dhe arsyetimin e gjykatave të instancës ma të ultë, sipas të cilit është aprovuar kërkesëpadia e paditësit, pasi që gjykata e shkallës së parë me pa mëdyshje ka vërtetuar se paditësi në bazë të kontratës së punës lidhur me të paditurën ka pasur gradën e të ardhurave personale 14, në bazë të nenit 5 të kësaj kontrate .

Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo Gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare.

Aktgjykimi i goditur nuk përmban të meta që kishin me ndikuar në ligjshmërinë e saj. Sikurse të dy gjykatat edhe kjo Gjykatë mendon se paditësi ka të drejtë në pagë e cila i caktohet të punësuarit me kontratë të punës në pajtim me Ligjin e Punës, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Paga e paditësit sipas kontratës së punës ka qenë në gradën 14-të dhe ulja nën këtë gradë është në kundërshtim me nenin 5 të kontratës së punës dhe dispozitën e nenit 55 par. 1 të Ligjit të punës (Gazeta zyrtare 03-L-212 – të RK) ku është përcaktuar se i punësuarit ka të drejtë në pagë e cila caktohet me kontratë të punës në pajtim me këtë Ligj, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit.

Nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se gjykata e shkallës së dytë, nuk ka vlerësuar të gjithë thëniet në ankesë, se gjykata e shkallës së dytë i ka vlerësuar të gjitha thëniet e ankesës së paditurës duke dhen arsyet e mjaftueshme dhe bindëse të cilat janë të pranuar edhe nga kjo. Thëniet tjera në revizionin janë përsëritje pretendimeve ankimore të cilat janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata Supreme vlerëson se me nenin 55 par. 1 të Ligjit të punës (Gazeta zyrtare 03-L-212 – të RK) është caktuar se i punësuarit ka të drejtë në pagë e cila caktohet me kontratë të punës e në pajtim me këtë Ligj, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Paga e paditësit sipas kontratës së punës ka qenë në gradën 9-të dhe ulja nën këtë gradë është në

kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe ligjit. Kërkesa e aksionarit Qeverisë së Republikës së Kosovës – Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, lidhur me uljen e shpenzimeve operative të e paditura në raport me të hyrat e përgjithshme nuk mund të jetë bazë për uljen e pagës së paditësit pasi që në rekomandimin e Qeverisë nuk janë precizuar se cilat shpenzime operative e as që thuhet për uljen e pagave dhe se e paditura është dashur ta paraqiste një plan të detajuar operativ lidhur me uljen e shpenzimeve duke i precizuar ato, por një provë e tillë nga ana e të paditurës nuk është paraqitur, çka thëniet e revizionit në këtë drejtim janë të pabazuara. Nuk ka prova se e paditura ka bërë ndërhyrjen në aktet normative të saja lidhur me zvogëlimin e gradave dhe se nuk mund të bëhet kjo me një vendim të drejtorit menaxhues.

Parashtrimet në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshitë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga dispozita e nenit 204 të LPK-së, pasi që nuk janë vlerësuar pretendimet në ankesë lidhur me afatshmërinë e padisë, kjo Gjykatë i vlerësoi se parashtrimet e tilla nuk përmbajnë bazë të vlefshme juridike për marrjen e vendimit më të favorshëm për të paditurit për faktin se kërkesa kryesore e paditësit është realizimi i të drejtës në diferencën e pagës, në këtë rast paditësi nuk është vonuar me paraqitjen e padisë nga se kontesti kryesisht ka të bëjë me pagesën e e diferencës së pagës për shkak të një vendimi arbitrar të kundërligjshëm të paditurës për zvogëlimin e pagës, për të cilën kërkesë në kuptim të nenit 87 të Ligjit të punës afati i parashkrimit është 3 vite e jo siç pretendohet pa bazë në revizion se afati për paraqitje të padisë për paditësin duhet të llogaritet në pajtim me nenin 78 dhe 79 të Ligjit të Punës.

Për arsyet e paraqitura më lartë, dhe në pajtim me nenin 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.309/2018, më 23.10.2018

Kryetar i kolegjit,  
Erdogan Haxhibeqiri